



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 03

Prishtinë, më 8.6.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selville Halimi, Albulena Haxhiu dhe Enver Hoti.

Munguan: Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliqeviq

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Jakaj – V.V., Visar Rushiti - GAP, Floriana Merovci-ZPRK, Floriana Shala – OSBE, Qendresë Mustafa – BIRN, Driton Selmanaj – KDI, Blerta Bejtullahu – EUSR/EV Office, Leotrim Berisha – Tribuna Channel, Erdi Pirana dhe Gentiana Dushi-praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 22.04. 2015;
3. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Puhie Demaku;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 22.04. 2015

***Kryetari** konstatoi se Nënkomisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve e mbajtura më 10 dhe 22.04. 2015, pa vërejtje.*

3. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryetari tha se jemi pajtuar të fillojmë me hartimin e Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe lidhur me këtë kemi përcaktuar edhe agjendën e radhës. Ai i njoftoi anëtarët se kemi planifikuar mbajtjen e një punëtorie, më 22 dhe 23 qershor, të organizuar nga OSBE-ja. Në vazhdim tha se puna jonë do të orientohet për draftin e hartuar nga projekti Hungarez i binjakëzimit.

Më tutje Nënkomisioni rishikoi dispozitat e Projektligjit për Kuvendin nga neni 1 deri te neni 4. Në preambulë u kërkuar të fshihen fjalët “Në kornizën e Projektit të Binjakëzimit, ky Projektligj për Kuvendin është përgatitur dhe propozuar për miratim”.

Po ashtu, në nenin 1 në paragrafin e parë fshihen fjalët “një kornizë ligjore”, në paragrafin 2.1 fshihen fjalët “po ashtu edhe” si dhe paragrafi 2.4 u riformulua si vijon:” përcaktimin e statusit të nëpunësit civil të Administratës së Kuvendit (në tekstin e mëtejme: nëpunësit civilë parlamentarë), dallimin e nëpunësit civil parlamentar, me stafin politik parlamentar”. Në nenin 2 u kërkuar të fshihen fjalët “dispozitat themelore që kanë të bëjnë me”, kjo vlen për paragrafët: 1,3,4 dhe 7. Kurse pas paragrafit 1.5 u shtua paragrafi 1.6 si vijon:” 1.6. statusin e deputetëve të Kuvendit, detyrat, përgjegjësitë dhe shpërblimet e tyre”. Në paragrafin 3 të nenit 2 u kërkuar që të fshihen numrat e ligjeve dhe të mbeten vetëm emrat e ligjeve.

4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Puhie Demaku

Kryetari tha se e keni parë kërkesën e deputetes Puhie Demaku, e cila ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, gjegjësisht nga drejtori i përgjithshëm, që në pajtim me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, të realizojë takim me të njëjtin për të marrë përgjigje për çështjet që janë të referuara në shkresën e datës 27.2.2015. Në shkresat e lëndës shihet vetëm një komunikim elektronik, duke ia pamundësuar deputetes në fjalë të realizojë takimin e kërkuar, apo të marrë përgjigje në formë të shkruar për çështjet e ngritura. Ligji nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, në nenin 13, përcakton obligimin e institucioneve që të presin me përparësi deputetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës sa herë që kërkohet për çështjet që lidhen me ushtrimin e detyrës së tij.

Për këtë pikë diskutuan Albulena Haxhiu dhe Enver Hoti, ku përkrahën kërkesën e ngritur dhe kërkuar që kjo çështje të trajtohet me seriozitet, pasi që është obligim ligjor dhe kushtetues i institucioneve.

Pas diskutimeve, Nënkomisioni vendosi që të hartojë një shkresë për Komisionin për Legjislacion, për procedim, ku pas miratimit nga Komisioni të njoftohet Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për moszbatimin e Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (neni 13) dhe të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj